



Pranuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	02.04.2021	1	viti god year
Organ / Njesia Org / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/IT/CK	1605/2021		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.133/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.133/2021 të datës 12.03.2021 të parashtruar nga nga Peja, kundër Vendimit me Nr:1130/2021 të datës 23.02.2021 të Ministres së detyrë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i filluar me ankesën me numër A.nr.133/2021 të datës 12.03.2021, të parashtruar nga ankuesi për shkak që objekti i ankesës është bërë i pamundur.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 04.02.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.413/2020 me të cilin ka obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që ankuesin ta kthejë në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit Nr. 97/2013 të datës 23.10.2013, dhe t’ia kompensojë 50% të pagës së humbur nga dita e pezullimit deri në pranimin e këtij vendimi.

Më datë 22.02.2021 zëvendësues Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nxjerr Vendim me Nr. Ref 38/2021 me të cilin ka zbatuar Vendimin A.nr.413/2020 të datës 04.02.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës.

Ministrja në detyrë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 23.02.2021 ka nxjerr Vendim me Nr: 1130/2021 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit

nga pozita "Drejtor i Përgjithshëm" në pozitën "Udhëheqës i Departamentit për Çështje Rajonale".

Ankuesi kundër vendimit të Ministres në detyrë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 12.03.2021 nëpërmjet ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me Nr. Prot: 1100/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 16.03.2021 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli më datë 29.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.133/2021 të datës 12.03.2021, me numër protokolli 1100/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 24.02.201 nga Zyra e Sekretarit në MPJD; Vendimin me Nr:1130/2021 i datës 23.02.2021 i Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendimin me Nr. Ref 38/2021 i datës 22.02.2021 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr. Ref 39/2021 i datës 22.02.2021 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr.Ref 40/2021 i datës 22.02.2021 i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin me Nr. Ref 105/2020 i datës 01.09.2020 i i zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimi Nr. 97/2013 për ankuesin; Njoftimin e datës 22.02.2021 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 29.03.2021; Konfirmimin për marrjen e detyrës i datës 30.03.2021 i dërguar nga ankuesi dhe Komunikimi i Ministres së MPJD-së me Kryetarin e KPMSHCK-së.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, pas zbatimit të Vendimit A.nr.413/2020 të datës 04.02.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, respektivisht kthimit të ankuesit në pozitën "Drejtor i Përgjithshëm", Ministria në detyrë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 23.02.2021 ka nxjerr Vendim me Nr: 1130/2021 me të cilin ka bërë transferimin e përkohshëm të ankuesit nga pozita "Drejtor i Përgjithshëm" në pozitën "Udhëheqës i Departamentit për Çështje Rajonale". Ankuesi i pakënaqur me transferimin ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për anulim të këtij vendimi dhe kthim në vendin e punës Drejtor i Përgjithshëm.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 29.03.2021 ka kërkuar nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandim lidhur me rastin e ankuesit duke e njoftuar që: "Ministria e Punëve të Jashtme e ka kthyer z.




vendin e tij të rregullt të punës. Ju lutem, më tregoni se a paraqet pengesë për një hap të tillë ankesa e re që z. ka dorëzuar në KPMSHCK”, ndërsa Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrë për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ministren se: “Sa i përket çështjes se z. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim ka kthyer z. në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në MPJD”.

Me qëllim të njoftimit lidhur me zbatimin e vendimit të KPMSHCK-së, kemi komunikuar edhe me ankuesin i cili më datë 30.03.2021 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nëpërmjet e-mailit se: “Ashtu siç biseduam përmes telefonit, ju konfirmoj se pas sqarimit me shkrim nga KPMSHCK, me kërkesën e Ministres z. Sekretari i Përgjithshëm ka dërguar e-mail ambasadave dhe drejtorive se unë jam rikthyer në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm... Ju informoj se në ndërkohë ministria e kaluar, znj. ka nxjerrë një vendim fantom plotësisht të paligjshëm, i cili nuk është subjekt trajtimi, meqenëse KPMSHCK tashmë kishte nxjerr vendim dhe z. Sekretari i Përgjithshëm ka ekzekutuar të njëjtin. Pra vendimet e lartpërmendura janë fuqizuar tashmë de facto, vetëm pas intervenimit të KPMSHCK-së me kërkesën e ministres dhe jo nën ditën e nënshkrimit, më 22.02.2021”.

Duke e shqyrtuar të gjitha provat e lëndës dhe duke vlerësuar rrethanat e reja të krijuara, respektivisht atë që ankuesi është kthyer në vendin e tij të punës “Drejtor i Përgjithshëm” në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës sipas Vendimit A.nr.413/2020 të datës 04.02.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, respektivisht Vendimit me Nr. Ref 38/2021 të datës 22.02.2021 dhe Vendimit me Nr. Ref 40/2021 të datës 22.02.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, atëherë sipas vlerësimit të Kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, Vendimi me Nr:1130/2021 i datës 23.02.2021 i Ministres në detyrë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është vendim i pavlefshëm në këtë rast nuk mund të jetë më objekt shqyrtimi.

Meqenëse kemi pranuar konfirmimin për marrjen e detyrës Drejtor i Përgjithshëm nga ankuesi, atëherë në bazë të këtyre rrethanave, objekti për të cilin ka filluar procesi i ankimit kundër Vendimit me Nr:1130/2021 të datës 23.02.2021 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është bërë i pamundur sepse pretendimet e ankuesit janë përmbushur, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”, dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bënë përfundimin e procedimit administrativ të filluar me ankesën e ankuesit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.133/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

